LIGJ
Nr. 83/2023

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10 083, DATË 23.2.2009, "PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRISË, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE *EVN AG, STATKRAFT AS* DHE *DEVOLL HYDROPOWER* SHA, SI BASHKËKONCESIONARË PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN NË PRONËSI, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TË HIDROCENTRALIT NË LUMIN DEVOLL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR, DHE MIRATIMIN E SHTESËS SË KATËRT TË KONTRATËS SË KONCESIONIT**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në titull dhe kudo në ligj, emërtimi "Ministria e Energjisë dhe Industrisë" zëvendësohet me emërtimin "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë".

Neni 2

Miratohet shtesa e katërt e kontratës së koncesionit, në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin e Devollit në Republikën e Shqipërisë ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktues, dhe *Statkraft AS* dhe *Devoll Hydropower* sh.a., si bashkëkoncesionarë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 3

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., për zbatimin e këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.11.2023.

Shpallur me dekretin nr. 339, datë 24.11.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

SHTESA e 4-t

E KONTRATËS SË KONCESIONIT NË LIDHJE ME PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN NË PRONËSI, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TË HIDROCENTRALIT NË LUMIN E DEVOLLIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË MES MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË (SI AUTORITETI KONTRAKTUES) DHE STATKRAFT AS DHE DEVOLL HYDROPOWER SHA (SI BASHKË-KONCESIONARË)

Kjo Shtesë e 4-t lidhet mes

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

si Autoriteti Kontraktues

dhe

STATKRAFT AS,

dhe

DEVOLL HYDROPOWER SH.A.

si Bashkë-Koncesionarë

(në vijim e quajtur "**Marrëveshja**" ose "**Shtesa e 4-t**")

24 **maj 2023**

Kjo Shtesë e 4-t e Kontratës së Koncesionit për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në Lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë e lidhur më datë 19 dhjetor 2008, e cila është miratuar nga Parlamenti shqiptar nëpërmjet ligjit nr. 10083, datë 23 shkurt 2009 dhe e publikuar në Fletoren Zyrtare shqiptare nr. 28, datë 17 mars 2009, dhe plotësuar nga Shtesa e 1-rë e Kontratës së Koncesionit datë 3 gusht 2010, e cila është miratuar me ligjin nr. 10337, datë 21 tetor 2010 dhe publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 154, datë 24 nëntor 2010 dhe plotësuar nga Shtesa e 2-të e Kontratës së Koncesionit datë 19 mars 2013, e cila është miratuar me ligjin nr. 105/2013, datë 28 mars 2013 dhe publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 53, datë 15 Prill 2013 dhe plotësuar nga Shtesa e 3-të e Kontratë së Koncesionit datë 18 dhjetor 2014, e cila është miratuar me ligjin nr. 7/2015, datë 12.02.2015 dhe publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 32, datë 9 mars 2015 (**"Kontrata e Koncesionit"**), lidhet sot më 24.05.2023, midis:

1. **MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, ish Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI), e ndodhur në Rr. "Abdi Toptani", Nr. 1, 1001 Tiranë, Shqipëri, (**"MIE"** ose **"Autoriteti Kontraktues"**),

Dhe

2. (a) **STATKRAFT AS,** një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Mbretërisë së Norvegjisë me seli në Lilleakerveien 6, 0283 Oslo, Norvegji, dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Norvegjisë me numër regjistrimi shoqërie 987 059 699 (**"STATKRAFT"**);

(b) **DEVOLL HYDROPOWER SHA**, një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën Rr. "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Zyra nr. 1206, Tiranë, Shqipëri dhe e regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit e Republikës së Shqipërisë me NUIS K82418002C (**"Shoqëria e Projektit"**),

Secili referuar si **"Bashkë-Koncesionarët"** dhe së bashku **"Koncesionari"**.

Secili prej Autoritetit Kontraktues, Bashkë-Koncesionarëve do të quhen individualisht **"Pala"** dhe bashkërisht **"Palët"**.

MEQËNËSE

A. Bazuar në Vendimin nr. 111, datë 02.03.2022 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i ndryshuar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, edhe në sektorin e energjisë, të burimeve energjetike, përfshirë edhe burimet e rinovueshme të energjisë, si dhe eficienca e energjisë; dhe ka trashëguar të drejtat dhe detyrimet e ish Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

B. Shoqëria e Projektit ka kryer disa studime paraprake të cilat synojnë optimizimin e shfrytëzimit hidrologjik të lumit Devoll. Studimet tregojnë se ndërtimi i një impianti me sistemin e rezervës së pompuar mund të jetë i realizueshëm dhe do të ofronte një përdorim më të mirë të potencialit hidrologjik të kaskadës së lumit Devoll. Nga optimizimi përfitojnë të dy Bashkë-Koncesionarët dhe Qeveria e Shqipërisë për shkak të shtimit të kapacitetit të ruajtjes së energjisë në vend.

PËR KËTË ARSYE, duke marrë parasysh sa më lart, Palët bien dakord si vijon:

1. INTERPRETIMI

Çdo fjalë me gërmë të madhe e cila nuk është përkufizuar në Shtesën e 4-t do të ketë kuptimin që i është dhënë kësaj fjale në Kontratën e Koncesionit.

2. NDRYSHIMET

2.1 Në Nenin 1 të Kontratës së Koncesionit, përkufizimet e mëposhtme do të ndryshohen si vijon:

*"**Autoriteti Kontraktues**" nënkupton ministrinë përgjegjëse për sektorin e energjisë në Republikën e Shqipërisë.*

*"**Pika e Livrimit**" është, për sa i përket një Hidrocentrali, pika ku matet Prodhimi Neto i Energjisë Elektrike dhe që gjendet në anën dytësore (110/220/400 kV) të transformatorit rritës ose të nënstacionit në centralin përkatës në pronësi të Koncesionarit dhe nëpërmjet të cilës Prodhimi Neto i Energjisë Elektrike kalon nga kontrolli dhe risku i Koçesionarit tek Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike.*

*"**Hidrocentralet**" nënkuptojnë Hidrocentralin e Banjës dhe Hidrocentralin e Moglicës dhe mund të përfshijnë Hidrocentralin e Kokel dhe/ose RP Moglica Shtesë, me kusht që Koncesionari zgjedh të ndërtojë Hidrocentralin Kokel dhe/ose RP Moglica Shtesë".*

*"**RP Moglica Shtese**" është nje Hidrocentral me sistemin e rezervës së pompuar që do të ndërtohet pranë Hidrocentralit Moglicë dhe i lidhur me rezervuarin Moglicë në Luginën e Lumit Devoll, sipas përshkrimit në Shtojcën A, duke përfshirë të gjitha punët civile dhe të gjitha instalimet elektro-mekanike, përfshirë por pa u kufizuar në turbinat, gjeneratorët, pajisje ndihmëse të stacionit elektrik, transformatorë, pajisja e Zonës së*

*"**Faza Para-Ndërtimit**" është periudha e kohës e cila fillon në Datën Efektive dhe përfundon në Datën e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit. Përjashtimisht, (i) në lidhje me Hidrocentralin Kokel, Faza Para-Ndërtimit do të konsiderohet se ekziston gjatë periudhës së kohës e cila fillon në Datën Efektive të Shtesës së 4-t deri në Fillimin e Punimeve të Ndërtimit për Hidrocentralin Kokel (nëse i njoftohet me shkrim Autoritetit Kontraktues nga Koncesionari) dhe (ii) në lidhje me RP Moglica Shtesë, Faza Para-Ndërtimit do të konsiderohet se ekziston gjatë periudhës së kohës duke filluar në Datën Efektive të Shtesës së 4-t deri në datën më të hershme ndërmjet dates së fillimit të Punimeve të Ndërtimit të RP Moglica Shtesë apo skadimin e afatit të përcaktuar në Nenin 7.2.2 (d) me kusht që Koncesionari nuk i ka dërguar njoftim me shkrim Autoritetit Kontraktues se ai ka zgjedhur të Ndërtojë RP Moglica Shtesë.*

***"Tatimi mbi Vlerën e Shtuar"** ose **"TVSH"** është tatimi mbi vlerën e shtuar që aplikohet në përputhje me Ligjin shqiptar nr. 92/2014, datë 24.07.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", me ndryshimet e tij të herëpashershme, si dhe çdo taksë tjetër e ngjashme që aplikohet mbi ofrimin e mallrave dhe të shërbimeve dhe mbi importin e mallrave."*

2.2 Neni 3.3.9 do t'i shtohet Kontratës së Koncesionit, sipas përmbajtjes në vijim:

"3.3.9 Afatet në Nenin 3.3 nuk do të zbatohen për RP Moglica Shtesë.
Një listë paraprake e aktiviteteve të cilat do të kryhen gjatë Fazës Para-Ndërtimit dhe Fazës së Ndërtimit të Hidrocentralit RP Moglica Shtesë është përfshirë ne Shtojcën A".

2.3 Seksioni 7.2.2 do të ndryshohet si vijon:

"Koncesionari do të fillojë Ndërtimin e:

a) Hidrocentralit të Banjës në Datën e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit;
b) Hidrocentralit të Moglicës nga koha e kërkuar për të finalizuar Ndërtimin e Hidrocentralit Moglicë sipas Nenit 7.2.3;
c) Hidrocentralit Kokel, brenda 10 (dhjetë) viteve pas përfundimit të Hidrocentralit Moglicë, nëse Koncesionari, në gjykimin e tij të vetëm, zgjedh të Ndërtojë Hidrocentralin Kokel;
*d) RP Moglica Shtesë, brenda 10 (dhjetë) viteve nga Data Efektive e Shtesës së 4-t, nëse Koncesionari, ne gjykimin e tij të vetëm, zgjedh të Ndërtojë RP Moglica Shtesë. Koncesionari do të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën e fillimit të Punimeve të Ndërtimit për RP Moglica Shtesë ("**Data e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit të RP Moglica Shtesë**")"*

dhe përfundojë Ndërtimin e Hidrocentraleve në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë.

2.4 Në fund të gërmës (a) të Nenit 7.3.14, do të shtohet fjalia në vijim:

"Brenda 60 ditëve nga njoftimi me shkrim i Koncesionarit për Autoritetin Kontraktues se Koncesionari ka zgjedhur të Ndërtojë RP Moglica Shtesë, Koncesionari do t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues një Garanci Kontrate thelbësisht në formën e përcaktuar në Shtojcën D (Formati i Garancisë së Kontratës) në një vlerë prej 6 milion Euro dhe në çdo rinovim të mëvonshëm Garancia e Kontratës për RP Moglica Shtesë do të jetë e vlefshme për të paktën një vit".

2.5 Neni 7.3.14 (d) do të ndryshojë si vijon:

"Autoriteti Kontraktues do të çlirojë plotësisht Garancinë e Kontratës të lëshuar për një Hidrocentral pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final për atë Hidrocentral".

2.6 Neni 2.5.1 do të ndryshohet si vijon:

"Koncesionari do të jetë përgjegjës për Ndërtimin e Linjave të Transmetimit me shpenzimet e tij. OST ruan të drejtën e pronësisë mbi Linjat e Transmetimit. Me përfundimin e punimeve të ndërtimit për çdo Linjë Transmetimi, Koncesionari dhe OST hartojnë aktin e vënies në punë të Linjave të Transmetimit me anë të procesverbalit të mbledhjes të nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të Koncesionarit dhe të OST-së. Linjat e Transmetimit do të konsiderohen se janë dorëzuar në datën e aktit të vënies në punë (me përjashtim të rasteve kur palët kanë nënshkruar një akt të veçantë dorëzimi, ku cilësohet një datë tjetër dorëzimi).
Për të shmangur çdo dyshim, OST merr në pronësi Linjat e Transmetimit, duke përfshirë punimet në proces gjatë ndërtimit. OST është përgjegjëse për kostot e mirëmbajtjes së Linjave të Transmetimit duke filluar nga data e dorëzimit të tyre.
Rregullat e mësipërme kanë përparësi ndaj dispozitave të çdo Marrëveshjeje për Lidhjen dhe Ndërtimin e një Shtese në Rrjetin e Transmetimit, që është nënshkruar apo do të nënshkruhet ndërmjet Koncesionarit dhe OST-së, dhe gjejnë zbatim për të gjitha Linjat e Transmetimit."

2.7 Shtojca A e Kontratës së Koncesionit do të zëvendësohet plotësisht me Shtojcën A të re bashkëngjitur këtu në Shtesën e 4-t.

3. ZBATIMI I MEKANIZMIT TË AUTOFATURIMIT TË TVSH-SË PËR HIDROCENTRALIN KOKEL DHE RP MOGLICA SHTESË

Palët rikonfirmojne se trajtimi i TVSH-së i përcaktuar në Nenin 2.8 të Kontratës së Koncesionit do te zbatohet edhe gjatë Fazës së Para-Ndërtimit dhe Fazës së Ndërtimit te Hidrocentralit Kokel dhe Hidrocentralit RP Moglica Shtesë. Koncesionari do të njoftojë autoritetet tatimore me shkrim për datën e fillimit të zbatimit të skemës së autofaturimit të TVSH-së.

Zbatimi i skemës së autofaturimit të TVSH-së nuk kushtëzohet nga lëshimi i njoftimit me shkrim të Koncesionarit për Autoritetin Kontraktues se Koncesionari ka zgjedhur të Ndërtojë Hidrocentralin Kokel dhe/ose RP Moglica Shtesë.

4. DETYRIMET E FAZËS PARA-NDËRTIMIT NËN PËRGJEGJËSINË E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Autoriteti Kontraktues konfirmon dhe i bën të ditur Koncesionarit angazhimin e tij për të përmbushur Detyrimet e Fazës Para-Ndërtimit nën përgjegjësinë e tij, sipas përcaktimit në Nenin 3.4 të Kontratës së Koncesionit.

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues sipas Nenit 3.4 të Kontratës së Koncesionit nuk kushtëzohen nga lëshimi i njoftimit me shkrim të Koncesionarit për Autoritetin Kontraktues se Koncesionari ka zgjedhur të Ndërtojë Hidrocentralin Kokel dhe/ose RP Moglica Shtesë.

5. ZONAT QË MUND TË HIQEN NGA SHESHI

Gjatë të gjithë Afatit, kur Koncesionari arrin në përfundimin se një pjesë e tokës brenda Sheshit nuk nevojitet më për qëllimet e Projektit, ai duhet të informojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Brenda një muaji nga njoftimi i Autoritetit Kontraktues, Palët do të diskutojnë dhe bien dakord për veprimet që do të ndërmerren për heqjen e asaj pjese toke nga Sheshi i Projektit dhe dorëzimin pranë autoritetit kompetent.

6. MIRATIMI NGA KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Autoriteti Kontraktues konfirmon dhe bën të ditur që Komisioni shqiptar i Ndihmës Shtetërore ka miratuar termat dhe kushtet kësaj Shtese të 4-t dhe/ose ka konfirmuar se nuk ka elementë të ndihmës shtetërore.

7. MIRATIMI NGA KËSHILLI I MINISTRAVE DHE RATIFIKIMI NGA PARLAMENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

7.1 Palët pranojnë se kjo Shtesë e 4-t do të hyjë në fuqi dhe do të ketë efekt të plotë në datën më të vonshme prej (i) nënshkrimit të saj nga Palët; (ii) datës së miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë; dhe (iii) 15 ditë pas datës së publikimit të ratifikimit të Shtesës së 4-t nga Parlamenti shqiptar në Fletoren Zyrtare (*fletorja zyrtare shqiptare*) (**"Data Efektive e Shtesës së 4-t"**).

7.2 Duke miratuar këtë Marrëveshje, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë autorizon Autoritetin Kontraktues për të vepruar dhe lidhur këtë Marrëveshje për llogari të Republikës së Shqipërisë e cila do të bëhet në këtë mënyrë Palë e kësaj Marrëveshjeje.

8. TË NDRYSHME

8.1 Autoriteti Kontraktues pranon dhe njeh që Koncesionari në asnjë rast nuk do të konsiderohet se nuk ka përmbushur apo se ka shkelur një pjesë tjetër të Kontratës së Koncesionit përveç kësaj Shtese të 4-t, për çdo dështim apo vonesë në përmbushjen apo kryerjen e detyrimeve sipas kësaj Shtese të 4-t.

8.2 Autoriteti Kontraktues njeh gabimin në versionin e përkthyer të publikuar të Kontratës së Koncesionit në lidhje me përkufizimin e "*Vëllimi i Prodhimit sipas Kontratës*" dhe pranon të zëvendësojë fjalët "*duke llogaritur*" me fjalët "*duke mos llogaritur*".

8.3 Palët bien dakord që dispozitat e përcaktuara në nenet 14.2, 14.4 deri në 14.6, 14.8 dhe 14.10 deri në 14.16 të Kontratës së Koncesionit do të zbatohen *mutatis mutandis* ndaj Shtesës së 4-t. Palët më tej bien dakord se dispozitat e arbitrazhit të përcaktuara në nenet 13.3.2 deri në 13.3.4 do të zbatohen gjithashtu për Shtesën e 4-t.

NË DËSHMI TË SA MË LART, Shtesa e 4-t është nënshkruar nga përfaqësues të Palëve të autorizuar në mënyrë të rregullt në ditën, muajin dhe vitin e përmendur më lart.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: Ilir Bajja

Emri:

Titulli: Deputy Minister of Infrastructure & Energy

STATKRAFT AS

Nga: Inge Løvåsen

Emri: SIMEN BRÆIN INGE LØVÅSEN

Titulli: SVP CFO

DEVOLL HYDROPOWER SHA

Nga: Rigels Çeppiqi

Emri: Rigels Çeppiqi

Titulli: Drejtore e Përgjithshme

SHTOJCAT

Shtojca A – PERMBLEDHJE E PROJEKT-IDESE SE RISHIKUAR TE KONCESIONARIT - PERSHKRIMI TEKNIK

SHTOJCA A

PERMBLEDHJE E PROJEKT-IDESE SE RISHIKUAR TE KONCESIONARIT - PERSHKRIMI TEKNIK

A) KERKESAT TEKNIKE MINIMALE

(a) Projekt-Ideja e Rishikuar dhe Projekti i Detajuar

Koncesionari ka pergatitur Projekt-Idene e Rishikuar per Luginen e Devollit me qellim kryesor shfrytezimin e potencialit hidroenergjitik duke arritur fleksibilitetin maksimal lidhur me prodhimin e energjise. Synimi paresor i projektit te propozuar eshte te arrije kerkesat e parashikuara te energjise elektrike nderkohe qe minimizon impaktin social dhe mjedisor.

Projekt-Ideja (e Rishikuar do te sherbeje si nje baze e pergjithshme per Projektin e Detajuar per tu dorezuar nga Koncesionari ne aplikimin e tij per nje Leje Ndertimi. Projekti i Detajuar mund te devijoje nga Projekt-Ideja e Rishikuar si rezultat i shqyrtimeve te metejshme te hollesishme gjeologjike, hidrologjike, mjedisore dhe teknike qe mund te kryhet nga Koncesionari pas miratimit te Projekt-Idese se Rishikuar, me kusht qe, gjithate keto devijime nuk do te cojne ne nje ndryshim te totalit te Kapacitetit te Instaluar per te gjithe Hidrocentralet ne total prej jo me shume se plus/minus 20% te 319 MW, dhe me kusht qe perdorimi i potencialit te lumit te jete bere nga te pakten tre Hidrocentrale ne zonen e Projektit.

(b) Strukturimi i Hidrocentraleve

Projekti ndodhet rreth 50 - 70 km ne juglindje te Tiranes ne pjesen qendrore-lindore te Shqiperise, ne jug te lumit te Shkumbinit. Zona i perket administrativisht prefektures se Elbasanit dhe Korçes, dhe eshte pjese e Rajonit Malor qendror jugor te shqiperise.

Lumi i Devollit e ka burimin e tij ne Malet e Gramozit ne nje lartesi prej 1 500 – 1 700 m mbi nivelin e detit. Pasi kalon luginen e Korçes ne drejtim perendimor, lumi i Devollit hyn ne rajonin malor te Gores afer qytetit te Maliqit, duke krijuar nje lugine te ngushte brenda formacioneve ranore dhe argjilore.

Lugina vazhdon te ngushtohet akoma me tej permes shkembinjve ultra-bazikë dhe shkembinjve ranoro/argjilorë te Paleogjenit.

Zona karakterizohet nga procese aktive erozioni me transport te konsiderueshem sedimentesh ne lumin e Devollit dhe degeve te tij, dhe sedimenteve pergjate pjeseve te uleta, te gjera te lugines se Devollit, e cila ka pjerresi me te ulet lumore.

Projekti perfshin tre hidrocentrale qe perdorin prurjet nga zona ujembledhese prej 2 890 km^2 ne rrjedhen e eperme te Banjes ne nje lartesi shfrytezimi nga 650 m m.n.d ne Moglice deri poshte ne 95 m m.n.d ne Banje. Per me teper, Projekti perfshin një Hidrocentral me sistemin e Rezervës së Pompuar (RP) te lidhur me Rezervuarin e Hidrocentralit Moglice, (ne vijim referuar si "RP Moglica Shtese", me Centralin e ndodhur midis Rezervuarit te Hidrocentralit Moglice dhe Rezervuarit te Eperm te RP Moglica Shtese e re ne lartesi rreth 1250 m.a.s.l.

Projekti Hidroenergjitik ka keto te dhena kryesore:

Hidrocentrali	**Shkarkimi i Projektuar**	**Kapaciteti i Instaluar (Turbina)**	**Prodhimi Mesatar**
HEC-i i Moglicës	65 m^3/s	177 + 1.2 MW	445 GWh/vit
HEC – i i Kokelit	73 m^3/s	35.2 MW	92 GWh/vit
HEC-i i Banjës	95 m^3/s	63.4 MW + min. 1.4 MW	252 GWh/vit
Gjithsej[1]		**278.2 MW**	**789 GWh/vit**
RP Moglica Shtese	230m3/s (+/-35%)	1200 MW (+/-35%)	Nuk eshte i disponueshem pasi varion gjate viteve

Sipas shpronesimit te tokes ne baze te kesaj Marreveshjeje, Koncesionari do te respektoje dhe ruaje te drejtat ekzistuese te paleve te treta per te marre uje per vaditje deri ne masen qe keto te drejta kane qene ligjerisht te autorizuara dhe faktikisht te perdorura ne Daten e Efektive.

(c) Pritshmeria e jetegjatesise se Projektit dhe Standardet e Ndertimit

Prtishmeria e jetegjatesise se projektit dhe standardet e ndertimit do te jene ne perputhje me praktikat e industrise se mire dhe standardet Europiane.

B) SHFRYTEZIMI I POTENCIALIT HIDROENERGJITIK TE LUMIT TE DEVOLLIT

Zona ujembledhese e Lumit te Devollit ka nje model prurjesh te theksuara sezonale me vere te thate dhe dimer te lagesht. Vershimi mesatar vjetor ne digen e Banjes eshte i perllogaritur ne 1 484 milion m^3.

Hidrocentrali i eperm, HEC-i i Moglices, do te shtrihet ne nje seksion te lumit te Devollit i me gjatesi 22 km dhe nje renie prej 300 m. Vepra marrese ne HEC-in e Moglices ndodhet ne rezervuarin e krijuar nga nje dige me mbushje shkembore me nje lartesi prej 150 m me berthame qendrore prej asfalto -betoni e njohur si Diga e Moglices. Centrali ndodhet nen siperfaqen e tokes ne shpatin verior te lumit te Devollit, dhe tuneli shkarkues eshte ne pjesen e eperme fundore të rezervuarit qe do te krijohet nga nje dige 53 m e larte, e njohur si Diga e Kokelit.

Hidrocentrali i mesem, HEC -i iKokelit, do te ndodhet ne nje shtrirje te lumit te Devollit me gjatesi 5.4 km me nje lartesi shfrytezimi prej rreth 55 m. Pjesa me e madhe e lartesise se shfrytezimit krijohet nga Diga e Kokelit, 50 m e lartë. Nje pjese e Diges eshte e perbere nga masiv betoni, pjesa tjeter eshte dige me mbushje guri me nje ekran asfalti ne anen e eperme te mbushjes se diges. Godina e HEC ndodhet mbi toke ne kembe te diges.

Hidrocentrali i poshtem, HEC-i i Banjes, ndodhet ne nje seksion gjatesor prej 16 km ne lumin e Devollit me nje lartesi shfrytezimi prej 77 m. Diga eshte projektuar si nje dige me argjinature me

[1] RP Moglica Shtese nuk perfshihet

nje lartesi maksimale prej rreth 85 m mbi shtratin fillestar te lumit. Diga ka nje berthame argjile te papershkueshme. Centrali i ndodhur mbi toke dhe kanali shkarkues fundor ndodhen ne rrjedhen e poshtme te diges ne shpatin jugor.

Pjese te Hidrocentralit te Banjes jane tashme te ndertuara, me punime te ndermarra midis fundit te viteve 1980 dhe 1995. Pritat dhe tubacioni i devijimit me porta hyrese jane perfunduar. Shkarkuesi fundor mundeson devijim ne nje niveli te ulet te lumit te Devollit. Gjate prurjeve te larta ne rezervuar rezervuari i krijuar mundeson nje grumbullim te ujit per te zbutur prurjet e shkarkimit ne anen e poshtme. Ndertimi i diges kryesore, perfshire galerine cimentuese, eshte perfunduar deri ne nje nivel prej 125 m dhe 130 m mbi nivelin e detit. Brenda kufirit te majte eshte germuar dhe perfunduar pjeserisht tuneli hyres dhe ai devijues.Keto struktura jane inspektuar dhe jane konsideruar te nje cilesie te mjaftueshme si baze per vazhdimin e ndertimit. Eshte germuar gjithashtu nje grope ne zonen e propozuar per godinen e centralit.

RP Moglica Shtese do te gjendet prane Rezervuarit te HEC-it Moglice dhe do te perdore ujin ne Rezervuarin e HEC-it Moglice. Lartesia maksimale e shfrytëzimit / rënia do te krijohet duke vendosur nje rezervuar te epërm ne kodrat mbi rezervuarin Moglice, (ne vijim referuar si "Rezervuari i Eperm i RP Moglica Shtese"). RP Moglica Shtese do te pompoje ujin nga Rezervuari i HEC-it Moglice ne Rezervuarin e Eperm te RP Moglica Shtese dhe do te gjeneroje energji kur uji te rrjedhe perseri pas ne Rezervuarin e HEC-it Moglice. Rezervuari i Epërm i RP Moglica Shtese do te krijohet duke ndertuar diga te mbushura me gure, te planifikuara kryesisht per ruajtjen ditore te ujit. Tunelet e ujit dhe centrali gjenden nen-toke.

Figurë 1: Paraqitja e kaskades se HEC-it te Moglices – HEC-it te Koklës – HEC-it te Banjes –RP Moglica Shtese

Figura 2: Ilustrim i RP Moglica Shtese

Hidrologjia

Lumi i Devollit (3140 m^2) eshte dega kryesore e lumit Seman (5950 km^2), nderkohe qe deget me te medha te lumit te Devollit jane Tomorrice (320 km^2), Malsise (300 km^2) dhe Dunavecit (275 km^2). Lumi i Devollit kalon permes disa zonave te ndryshme klimaterike. Karakteristikat kryesore te ketyre zonave klimaterike jane vere e thate dhe dimer i lagesht.

Per shkak te pozicionit gjeografik dhe largesise nga deti, reshjet ndryshojne dukshem pergjate lumit. Rrjedha e eperme e basenit lumor ka nivelin me te ulët te reshjeve ne Shqiperi, nderkohe qe pjesa malore e zones se mesme arrin sasi dukshem me te larta. Zona eshte gjithashtu e karakterizuar nga nje intensitet i ulet reshjesh, me mesatare vjetore maksimumi 24 ore reshje me vlere prej 40-80 mm. Debora ne dimer eshte e zakonshme, dhe maksimumi i monitoruar i trashesise se debores eshte deri ne 2 m. Numri i diteve te mbuluara me debore ne vit mund te varioje nga rreth 30 dite ne pjeset e uleta, deri ne rreth 90 dite ne zonat malore.

Jane kryer analiza gjitheperfshirese mbi te dhenat per prurjet dhe reshjet per zonen ujembledhese. Vlerat mesatare vjetore te prurjeve per sheshet e digave ne rrjedhen kryesore jane vleresuar ne baze te te dhenave nga periudha 1953-2005.

1.1.1.1.1.1.1 Prurjet mesatare vjetore ne sheshet e diges.

Sheshi i diges	Siperfaqja (km^2)	HRWL*) (m m.n.d.)	OFWL**) (m m.n.d.)	Prurjet mesatare vjetore		
				($l/s/km^2$)	(m^3/s)	mil. m^3/vit
Moglicë	1671	650	651.5	13.1	21.8	689
Kokel	1885	350	350	14.4	27.1	854
Banja	2890	175	176.5	16.3	47.1	1484

*) HRWL = niveli me i larte i rregullator i ujit

**) OFWL = niveli me i larte i ujit gjate operimit (do te perdoret per kontrollin e permbytjeve)

Kapaciteti depozitues i rezervuareve

	RP Moglica Shtese	Moglicë	Kokel	Banje	Gjithsej[2]
Vellimi i shfrytezueshem (mil m^3)	5-20	152	15.2	178	345.2
Vellimi i vdekur (mil m^3)	0	210	4.3	213	427.3

[2] RP Moglica Shtese nuk perfshihet

Sizmiologjia

Shqiperia gjendet ne rripin sizmik te Mesdheut-Alpin dhe perben pjese te lidhjes mes mikropllakave te Adriatikut dhe pllakave euroaziatike. Sizmiciteti ne vend karakterizohetr nga nje aktivitet intensiv termetesh te vogla dhe termete te mesatare, te ndryshmenga ngjarje te medha. Shkaku kryesor per veprimtarine sizmike ne Shqiperi eshte goditja midis mikropllakave te Adriatikut dhe formimit te maleve shqiptare.

Te gjitha strukturat do te vleresohen per ngarkesa termeti. Metoda e projektimit, gati-statike ose dinamike, do te zgjidhet ne baze te karakteristikave te elementeve te projektuar dhe klasifikimit sipas sigurise/ pasojave te tyre. Elementet strukturore do te diferencohen sipas pasojave te deshtimit te tyre. Strukturat ku humbja e funksionalitetit ka pasoja te medha perfshire diga dhe struktura te tjera kritike per sigurine e diges do te kontrollohen per nje periudhe kthimi prej 1 ne 500 vjet si nje ngarkese e ndryshueshme dhe 1 ne 10 000 vjet si nje ngarkese aksidentale. Struktura te tjera do te kontrollohen vetem per nje periudhe kthimi prej 1 ne 2 000 vjet si nje ngarkese aksidentale. Kombinime te ndryshme ngarkesash pa pasur humbje ne funksionueshmeri duhet te tolerohen, ndersa per kombinime aksidentale ngarkesash, mund te tolerohen demtime mbi struktura, por nuk duhet te ndodhe shembje.

Faktoret e ngarkeses/faktoret e sigurise do te jene ne perputhje me rekomandimet perkatese nderkombetare dhe kodet e projektimit.

C) HEC-i i MOGLICES, SKEMA E PERGJITHSHME

Hidrocentrali i Moglices eshte Hidrocentrali i Eperm i te tre Hidrocentraleve qe formojne Projektin Hidroenergjitik te Devollit.

Diga e Moglices se bashku me vepren e marrjes ndodhet perafersisht 1.5 km poshte pikes se bashkimit te lumit te Malsise dhe lumit te Devollit, nderkohe qe shkarkimi i kanalit fundor ndodhet ne lumin e Devollit rreth 300 m siper pikes se bashkimit midis deges se Graboves dhe lumit te Devollit.

Godna e centralit nentokesor ndodhet ne shpatin verior perafersisht 1.25 km jug-juglindje te bashkimit te deges Grabove me lumin Devoll.

Skema shfrytezon nje lartesi maksimale shfrytezimi/ renie prej 300 m midis HRWL ne rezervuarin e Moglices ne lartesine prej 650 m mbi nivelin e detit poshte deri ne HRWL-ne ne Rezervuarin e Kokelit ne nje lartesi prej 350 m mbi nivelin e detit. Si mase per reduktimin e permbytjeve, kuota e ujit ne digen e Moglices mund te shkoje deri ne 651.5m mbi nivelin e detit. Nga vepra marrese ne lartesine prej 610 m mbi nivelin e detit prurja llogaritese prej 65 m^3/s e turbinave transmetohet permes tunelit te devijimit prej 10.8 km te gjate prej te cilit rreth 6.5 km do te germohen nga nje makineri per hapjen e tuneleve (TBM) dhe pjesa e mbetur me shpim dhe teknika shperthimi.

Ne fund te rrjedhes se poshtme te tunelit te devijimit, uji do te hyje ne dy tubacione çeliku paralelë me nje diameter prej 3.2 m, perkatesisht 50 m dhe 65 m te gjatë, qe te çojne tek dy turbinat Francis. Nje tunel fundor 890 m i gjate me nje seksion te terthor prej 37 m^2 rikthen rrjedhen e turbines ne lumin e Devollit.

Ne zonen e projektit mund te arrish nga zonat e rrjedhes se eperme dhe ato te poshtme nga nje rruge qe shkon paralelisht me lumin permes Lugines se Devollit.

Projekti perfshin pjeset kryesore si ne vijim:

- Diga e Moglices, nje dige me mbushje shkembore 150 m e larte me nje berthame asfalti te vendosur ne qender (ACC);
- Tuneli i poshtem i shkarkimit dhe tuneli i derivimit, me porta ndaluese ne vepren e marrjes dhe 2 porta rreshqitese;
- Tuneli i eperm i shkarkimit me dy porta rreshqitese;
- Nje kaperderdhes me porta ne shpatin e djathte me 3 porta radiale, nje rreshqitese dhe nje pus shuarjeje
- Nje hidrocentral te vogel ne kembe te diges per te perdorur rrjedhen e lire mjedisore;
- Hyrjen me skare per mbledhjen e mbetjeve dhe nje porte rrotulluese per tunelin e derivimit te ujit, te kombinuar me nje hyrje per hidrocentralin e vogel dhe pajisjet per pastrimin dhe hidrothithjen e sedimenteve;
- Mikro tunele te veshur; nje per hidrocentralin e vogel dhe nje per sistemin e pastrimit dhe hidrothithjes se sedimenteve;
- Nje tunel derivimi 10.8 km i gjate me 3 tunele inspektimi;
- Nje tunel i pjerret i vershimit me nje gjatesi prej 0.8 km;
- Dy tubacione nentokesore te medha çeliku, nga nje per secilen turbine;
- Nje central nentokesor me nje shpelle dhe nje shpelle per transformatorin te dyja te lidhura me siperfaqen e tokes nepermjet nje tuneli 0.5 km te gjate dhe nje tuneli te vecante prej 0.7 km te gjate, tunel i kombinuar shpetimi dhe kalimi te kabllove Nje tunel fundor 0.9 km te gjate i cilin te çon ne rezervuarin e krijuar nga diga e Kokelit ne lumin e Devollit;
- Nje mekanizem ndalues ne dalje te tunelit shkarkues fundor;
- Nje tunel 0.2 km te gjatete kombinuar me tunele hyrese - dhe tunele vershimi per ne shkarkuesin fundor;
- Nje godine portale ne tuneli e kalimit; dhe
- Nje nenstacion me godine kontrolli;
- Nje linje transmetimi 220 kV prej 51.5 km te gjate mes nenstacionit te Elbasanit II dhe HEC-it te Moglices;
- Nje linje 35 km e gjate 22 kV per shperndarje ne sheshet e ndryshme te ndertimit.

Gjeologjia

Zona e Diges se Moglices

Diga e Moglices ndodhet ne nje kanion, shume te pjerret ne shpatin e djathte. Pjesa me e madhe e diges gjendet ne nje masiv konglomerat, i cili shtrihet mbi flishet (*Flysch*). Kufiri mes dy llojeve te shkembinjve perkulet 25-30 grade drejt veri-lindjes. Themeli ne shpatin e majte perbehet nga shkembinj dhe mbetje te "pa konsoliduara", deri ne nje thellesi te hamendesuar prej perafersisht 100 m.

Njesite kryesore litologjike brenda perkuljeve ose thyerjeve te shesheve te diges jane:

- Konglomeratet
- Masive te gureve ranore
- Alternim guresh ranore dhe argjilore

Inspektimet tregojne depertueshmeri mesatare dhe deri ate te larte dhe ne 20 m e siper te konglomeratit dhe thellesi mesatare deri ne te ulet ne thellesi. Pritet te kete zona sub-horizontale, pjeserisht te mbushura, te cilat mund te kerkojne veshje.

1.1.1.1.2 Skema dhe projekti i pergjithshem nentokesor

Baza per tunelin dhe skemen e projektit eshte nje vend i caktuar i vepres se marrjes ne sheshin e Diges se Moglices dhe nje vendndodhje lokale e optimizuar e tunelit shkarkues. Vendndodhja e centralit dhe sistemi i tuneleve perkates eshte kryesisht i rregulluar nga kriteret teknike qe vijne si pasoje e projektimit te hidrocentralit, kushteve topografike dhe gjeologjike.

Shtrirjet e propozuara, vendndodhjet dhe konceptet korresponduese per projektimin e tunelit konsiderohen te pranueshme dhe ne nje ane konservatore ne kete faze te projektimit, bazuar ne njohurine aktuale gjeologjike, mekanike, tabela standardesh dhe eksperience praktike.

Shtrirja e rekomanduar per vijen e ujit eshte perzgjedhur ne baze te rruges me te shkurter te mundshme duke konsideruar mjaftueshem mbulimin e anes, mbingarkimin dhe nivelin e ujit nentokesor.

Skema e organizimit te tunelit per vijen e ujit eshte e ndare ne seksionet ne vijim:

- Tuneli i derivimit Moglice-Shemsit eshte i dominuar nga nje seri flishesh te nderprere nga shtresa ranore dhe konglomerate. Ky seksion do te germohet nga nje makineri per shpimin e tunelit e cila vazhdon instalimin e veshjes segmentale per te gjithe shtrirjen.
- Tuneli i derivimit ne pjesen e eperme te tunelit hyres te Shemsit eshte germuar per te takuar TBM nga vepra marrese e Moglices. Ky seksion eshte rekomanduar si tunel konvencional shpim e shperthim, pjesa me e madhe e pritshme te jete e veshur me beton.
- Tuneli i Shemsit deri ne tuneli inspektues te derivimit supozohet se ndodhet mbi shkembinj te forte ofiolitik dhe supozohet te germohet me metoda konvencionale shpim e shperthim.
- Pjesa e poshtme e tunelit te derivimit drejt centralit supozohet te jete vendosur ne gure relativisht te forte ofiolitik dhe rekomandohet te germohet nga nje metode konvencionale shpim e shperthim.
- Tuneli i prurjeve supozohet te germohet ne shkembinj pjeserisht te forte ofiolitik dhe eshte rekomandohet te germohet nga nje metode konvencionale shpim e shperthim.

Plani nentokesor ne zonen e centralit konsiston ne elementet e meposhtem:

- Centrali dhe shpella ee transformatoreve
- Tuneli i kalimit per ne ndertesen e centralit
- Tuneli kabllor dhe ai i shpetimit nga centrali per ne siperfaqe

- Tuneli i inklinuar i derivimit germuar nga shpella e centralit
- Tuneli shkarkues fundor

Punimet nentokesore ne zonen e centralit supozohet te germohen ne shkembinj relativisht te forte ofiolitike me cilesi te mases shkembore kryesisht mesatare me disa seksione te varfra dhe shkembinj jashtezakonisht te dobet. Te gjithe keto tunele dhe shpella rekomandohen te germohen nga metoda Shpim e Shperthim.

Çeshtje mjedisore te nje rendesies pecifike per fizibilitetin dhe projektimin

Si pasoje e krijimit te Rezervuarit te Moglices, zonat tokesore ne luginen e eperme te Devollit do te permbyten mbi nje gjatesi prej perafersisht 22 km. Ndikimet sociale dhe mjedisore jane identifikuar dhe masat per minimizimin e tyre pershkruhen ne raportin VNMS-se. Ndikimi kryesor mjedisor mund shihet ne lidhje me ndryshimet ne regjimin hidrologjik te lumit te Devollit. Devijimi i ujit ne digen e Moglices do te pakesoje prurjet ne Devoll ne zonen midis sheshit te diges dhe rezervuarit te Kokelit. Kjo do te zbutet me shkarkim te rrjedhes minimale. Ndikimet sociale kryesore jane humbja e tokes bujqesore dhe hortikulturave, dhe humbja e standardeve te jeteses e kushtezuar nga to. Nevojitet risistemimi i shtepive ne 2 fshatra, Nikollare dhe Lumaj, dhe zevendesimi i infrastruktures ekzistuese (si p.sh. shkolla dhe infrastruktura shendetesore, rindertimi i rrugeve etj). Minimizimi i duhur i pasojave do te iniciohet ne bashkepunim me Qeverine e Shqiperise kur te jete e pershtatshme si per mjedisin ashtu edhe per personat e prekur nga projekti.

D) SKEMA E PERGJITHSHME E HEC-it TE KOKELIT

HEC-i i Kokelit perdor nje lartesi shfrytezimi prej 55 m mes lartesise 350 m.m.n.d dhe lartesise 295 m.m.n.dne lumin Devoll, te krijuar nga diga e Kokelit perafersisht 53 m e larte, e projektuar si nje dige graviteti prej betoni e lidhur me nje dige me mbushje shkembore me shtrese asfalti drejt shpatit te djathte Centrali dhe shkarkuesi fundor jane te vendosur ne shpatin perendimor ne kembe te diges prej betoni. ne. 5 m e fundit te lartesise se shfrytezimit jane marre duke ulur shtratin e lumit duke ndertuar kanale ne nje gjatesi prej perafersisht 600 m nga dalja e tunelit shkarkues fundor.

Ne zonen e projektit mund te arrishnga zonat e rrjedhes se eperme dhe ato te poshtme nga nje rruge qe shkon paralelisht me lumin permes Lugines se Devollit.

Projekti i Kokelit perfshin keto pjese kryesore:

- Rruget hyrese
- Digen e Kokelit qe perfshin:
    - Nje seksion te diges me mbushje shkembore dhe shtrese asfaltiNje seksion dige graviteti prej betoni me vepra hyrese tubacione per ne central, kaperderdhes dhe tuba per pastrimin e sedimenteve dhe devijimin gjate ndertimit;
- Nje pus shuarjeje
- Nje central mbi siperfaqen e tokes me pajisje prodhimi energjie;
- Nje kanal shkarkues fundor;

- Nje godine me ingranazh kontrolli te izoluar me gaz; dhe
- Lidhjen me linjen e transmetimit 220 kV Elbasan II – nenstacioni i Moglices.

Zona e Kokelit – kushtet e themelit:

Kuadri gjeologjik ne sheshin e diges se Kokelit eshte i formuar nga litologjite e kufirit te ofioliteve ultrabazike te masivit te Devollit. Ne aspektin tektonik ato i perkasin zones se Mirdites.

Rezultatet e shpimit dhe hartezimi i detajuar tregojne se sheshi i diges karakterizohet nga litologjite e kufirit (sekuencat Melangje) te masivit te Devollit te cilat mund te ndahen ne tre nenlloje. Ato jane vertete kombinime tektonike melangje me perberje heterogjene.

Shpati i majte i diges eshte ndertuar nga Amfibolite dhe Serpentite te zones argjilore. Te monitoruara ne nje shkalle me te madhe keto Amfibolite dhe Serpentinite jane thjesht trupa te prere ne zonen argjilore te therrmuar, por si trupa te prere jane mjaftueshem te medhenj per te krijuar nje shpat te majte te qendrueshem me kushtet me te me te mira te mundshme te mases shkembore.

Mund te supozohet per centralin se pjesa me e mire gropes/tunelit te germuar do te ndodhet ne sedimente aluviale te lumit te Devollit te gershetuara me papasterti nga shpati i majte. Shpati perendimore e tunelit/gropes se centralit ka shume gjasa qe te jete shkemb amfobolitik.

Sjellja e masave gurore gjate germimit do te percaktohet nga nje pjese ranore dhe orientimit te permbajtjes se preferuar.

Niveli zero i germimit te centralit te Kokelit eshte perafersisht 280 m.m.n.d. Germimi do te rezultoje ne gropa te pjerreta deri ne nje lartesi prej 30 m pergjate skajit jug-perendimor. Ne pergjithesi orientimi qe perkulet paralel me luginen nuk eshte i favorshem. Pjerresia e shpatit, lartesia e mureve dhe mbeshtetja e perforcuar si edhe dhe shtrengimi me gure sistematik dhe/ose ankorimi duhet te projektohen sipas cilesive te masiveve-shkembore mekanike dhe analizes se detajuar te permbajtjes qe eshte per t'u kryer ne fazen e ardhshme te projektimit.

Çeshtje mjedisore te nje rendesie specifike per fizibilitetin dhe projektimin

Si pasoje e krijimit te Rezervuarit te Kokelit, zonat tokesore ne mes te lugines se Devollit do te permbyten mbi nje gjatesi prej perafersisht 5.4 km. Ndikimet sociale dhe mjedisore jane identifikuar dhe pakesuar siç pershkruhet ne raportin e VNMS-se. Ndikimet sociale jane te moderuara ne krahasim me ato te HEC-it te Banjes dhe HEC-it te Moglices, por ka humbje te tokes bujqesore dhe hortikulturave, si edhe dhe humbja e standarteve te jeteses e ksuhtezuar nga to. Ka nje vend me specie bimesh endemike ne zonen ne te cilen mund te kete impakt per shkak te punimeve ndertimore. Minimizimi i duhur ipasojave do te iniciohet ne bashkepunim me Qeverine e Shqiperise kur te jete e pershtatshme si per mjedisin ashtu edhe per personat e prekur nga projekti.

E) SKEMA E PERGJITHSHME E HEC-it te BANJES

HEC-i i Banjes perdor nje lartesi shfrytezimi mes 175 m .m.n.d dhe 95 m m.n.d. Hidrocentrali ndodhet perafersisht 14 km poshte rrjedhes ne qytetin e Gramshit. Plani i pergjithshem eshte ne parim i njejte me planet fillestare shqiptare per projektin. Diga dhe tuneli i derdhjes eshte lene pjeserisht i perfunduar pasi zona u braktis ne vitet 90.

Rezervuari i krijuar nga diga e Banjes do te jete perafersisht 80 m i larte. Si mase per pakesimin e permbytjes struktura e diges mund te behet qe te perballoje nivelin me te larte gjate operimit (OFWL) prej 176.5 m .m.n.d. Diga eshte projektuar si nje dige argjinature me berthame te papershkueshme argjili. Hyrja ne rezervuarin e Banjes ndodhet pak siper diges ne shpatin e majte te lumit te Devollit. Hyrja me porta per mbylljen e tunelit te derivimit do te instalohet ne nje kulle te ndare. Nje porte çeliku do te drejtoje ujin tek centrali qe ndodhet ne siperfaqe. Nga centrali nje kanal shkarkues fundor do ta ktheje ujin ne lume. Hidrocentrali do te pajiset me dy njesi Francis dhe nje njesi te vogel per shkarkimin minimal me nje total te kombinuar te kapacitetit te turbinave prej 63.4 MW + min. 1.4 MW.

Madhesia e njesise se vogel mund te rritet ne menyre qe te sherbeje me mire per ujin per vaditje. Mesatarja vjetore e perllogaritur per prodhimin e energjise eshte 252 GWh.

Devijimi ekzistues i lumit nen dige do te vihet ne funksion per kohezgjatjen e punimeve te ndertimit, por do te behet i perhershem pas mbylljes se pare. Nje mundesi tjeter per te ulur nivelin e ujit ne rezervuar mundesohet nepermjet nje degezimi ne porta dhe nje kanal emergjence per uljen e nivelit.

Hidrocentrali i Banjes perfshin keto pjese kryesore:

- Rruget hyrese;
- Digen e Banjes;
- Kaperderdhesin;
- Vepren e marrjes, tunelin e derivimit (veshje çeliku ne tunel dhe porta pjeserisht nentoke);
- Central mbisiperfaqen e tokes me pajisje prodhimi te energjise;
- Kanal shkarkues fundor;
- Sistem per te mbledhur sedimentet; dhe
- Nje dalje emergjence (degezim i portes dhe kanalit).
- Nenstacion;
- Linje te re transmetimi 110 kV 11.5 km te gjate deri ne nenstacionin e Cerrikut;
- Rindertim te linjes 35 kV mes Banjes dhe Mjekes.

Gjeologjia e zones se Banjes

Ne zonen e Diges se Banjes fiziografia e lugines se Devollit eshte ajo e nje lugine te gjere lumore. Brenda bazes se lugines hasen depozitime aluviale qe shtrihen mbi nje formacion me permbajtje flishe Depozitimet aluviale vleresohet te jene mes 5 m deri 15 m te gjere.

Anet e lugines jane te mbuluara nga nje shtrese materiali te perthithur nga toka (dhe i gerryer i transportuar poshte neper shpat). Ne pjese te shpateve te lugines mund te gjendet nje konglomerate, dobesisht e çimentuar, mbi themelet me flishe.Konglomerati mund te jete gjithashtu i pranishem nen depozitat aluviale ne baze te lugines. Duhet te parashikohen burime ne kontakt me konglomeratet.

Thellesia e erozionit te themelit prej flishesh eshte raportuar te varioje nga 0.5 m deri ne 1.5 m nen depozitat aluviale brenda shtratit te lumit mes 4m deri ne 8m mbi shpatet e lugines.

Struktura gjeologjike ne zonen e diges eshte e karakterizuar nga nje strukture e pjerret sinklinale , aksi i te ciles perkulet drejt jug-lindjes ne drejtim te rrjedhes se eperme. Struktura sekondare sinklinale dhe antiklinale jane te pranishme. Nje thyrje masive e perkulur kalon neper kufirin e djathte. Raportime te meparshme sugjerojne qe ka pasur zhvendosje te "vogla" pergjate kesaj thyerjeje.

Vete diga ekzistuese e Banjes eshte kryesisht e ndodhur ne nje zone te dominuar me gure ranore rralle here te nderthurur me gure argjilore. Rezervuari i Hidrocentralit te Banjes eshte teresisht i ndodhur ne formacionin e flisheve te Krujes.

Çeshtje mjedisore te nje rendesie specifike per fizibilitetin dhe projektimin

Si rezultat i krijimit te Rezervuarit te Banjes, zonat tokesore ne luginen e poshtme te Devollit do te permbyten ne nje shtrirje prej perafersisht 13.5 km. Ndikimet sociale dhe mjedisore jane identifikuar dhe masat per pakesimin e tyre jane pershkruar ne raportin e VNMS-se. Ndikimi kryesor mjedisor mund shihet ne lidhje me ndryshimet ne regjimin hidrologjik te lumit te Devollit. Regjimi hidrologjik do te ndryshoje ne rrjedhen e poshtme te diges se Banjes. Kjo do te pakesohet me shkarkim minimal te qarkullimit. Ndikimet sociale jane humbja e tokes bujqesore dhe hortikulturave, si edhe dhe humbja e standarteve te jeteses kushtezuar nga to. Eshte identifikuar gjithashtu nevoja per zhvendosjen e shtepive pergjate rezervuarit dhe nje nevoje per te zevendesuar infrastrukturen ekzistuese (si p.sh. shkolla, rindertim te rrugeve dhe urave etj). Minimizimi i duhur i pasojave do te iniciohet ne bashkepunim me Qeverine e Shqiperise kur te jete e pershtatshme si per mjedisin ashtu edhe per personat e prekur nga projekti.

F) PLANI I PERGJITHSHME I RP MOGLICA SHTESE

Rezervuari i Eperm i RP Moglica Shtese gjendet rreth 8 km ne lindje te Diges se Moglices ku nje pjese e eperme ne formen e nje ene dhe pjese e eperme relativishte e sheshte e lugines eshte e pershtatshme per ruajtjen ditore te ujit per t'u perdorur nepermjet nje hidrocentrali me sistemin e rezervë së pompuar.

Rezervuari i Eperm do te perbehet nga 2 diga me mbushje shkëmbore ne lartesi nga 20 deri 70 m.

Centrali nen-tokësor gjendet ne kodren ne anen e majte te deges se lumit Devoll te rezervuarit të Moglices. Centrali eshte i pajisur me turbina me pompe te kthyeshme. Kapaciteti i instaluar do te jete afersisht 800-1600 MW subjekt i projektit final. Dalja e tunelit të shkarkimit do te zhytet dhe do te dale ne Rezervuarin e HEC-it Moglice rreth 4 km nga Diga e HEC-it Moglice.

Skema perdor nje lartësi bruto rreth 620 m midis Rezervuarit te Eperm te RP Moglica Shtese dhe Rezervuarit te HEC-it Moglice. Prurja maksimale e turbines prej 230 m^3/s ± 35% percillet nepermjet nje tuneli uji nen-tokesor të gjate rreth 5-7 km duke perfshire tunelin e presionit dhe tunelin e shkarkimit. Seksione te shkurtra para dhe pas Centralit do te vishen me celik. Nevoja per pus shuarje do te vleresohet gjate pergatitjes se Projektit te Detajuar

Energjia per sistemin shqiptar të Transmetimit të Energjisë Elektrike do te dorezohet te Pika e Lëvrimit, ne nenstacionin 400 KV (mbi toke) prane vendndodhjes se Centralit të RP Moglica Shtese (nen-toke).

RP Moglica Shtese perfshin pjeset kryesore ne vijim:

- Rruget hyrese (ekzistojne pjeserisht);
- Rezervuari i HEC-it Moglice (Rezervuari i Poshtem, Ekzistues);
- Rezervuari i Eperm i RP Moglica Shtese (Rezervuari i Pompuar; i Ri);
- Tunele uji nen-tokesore (nga Rezervuari i Eperm ne Rezervuarin e Poshtem);
- Central nen-tokesor me pajisjet e gjenerimit & transformatoret;
- Zona e pajisjeve elektrike/Nenstacioni 400 kV mbi toke;
- Linja e trasmetimit 400 kV per lidhjen ne piken e bashkimit (coupling);
- Linja e trasmetimit e tensionit te mesem per shperndarjen ne kantiere te ndryshme ndertimi dhe rezervuarin e eperm.

Zona e Projektit mund te arrihet nga infrastruktura e ngritur tashme ne HEC-in Moglice.

Projekt-Ideja e Rishikuar e cila i perket RP Moglica Shtese do te sherbeje si baza e pergjithshme per Projektin e Detajuar qe do te dorezohet nga Koncesionari ne aplikimin e tij per Leje Ndertimi, ku do te percaktohet perfundimisht edhe vellimi dhe kapaciteti i instaluar i Rezervuarit te Eperm te RP Moglica Shtese.

Gjeologjia e RP Moglica Shtese

Zona e Rezervuar te Eperm te RP Moglica Shtese

Rezervuari i Eperm gjendet ne nje formacion kryesisht te shkembinjve te forte ofiolitik. Zona ka nje shtrese toke relativisht te ceket me disa dalje shkembinjsh ne vendndodhjen e diges. Synimi eshte te nxirret sa me shume te jete e mundur nga materiali shkembor per digat brenda zones se rezervuarit.

Tunelet e ujit dhe Centralit i RP Moglica Shtese

Tunelet e ujit dhe Centralit jane ne pjesen me te madhe te vendosura ne nje formacion kryesisht me shkembinj te forte ofiolitik dhe te planifikuar per t'u germuar me menyren klasike te shpimit & shperthimit.

Dalja e Tunelit të Shkarkimit do te germohet ne shkemb flish, ashtu siç janë jane germuar edhe tunelet e HEC Moglice.

GRAFIKU PARAPRAK I RP MOGLICA SHTESE

Ky grafik i cili është dhënë nga Koncesionari si tregues, jo i detyrueshem dhe i dhene vetem per qellime informimi.

Tregues

Afati kohor	***Faza***	***Gjendja***
TM2 2023	Hyrja në fuqi e Shtesës së 4-t	Ngjarja e nisjes
TM2 2023	Faza e para-fizibilitetit	Fillimi i aktiviteteve
TM1 2024	Faza e fizibilitetit • Fizibiliteti teknik • Vleresimi tregtar • Transmetimi dhe lidhja • Mjedisore dhe sociale • Licensa dhe leje	Fillimi i aktiviteteve
TM1 2025	Arritjet kryesore per vijimin me tenderimin e kontrates kryesore 1. Lidhja e kontratatave tregtare afat-gjata kryesore (ne Shqiperi dhe ne rajon). 2. Planet dhe angazhimet e kerkuara qe permirësimi/investimet në sistemin e transmetimit dhe interkonjeksionit jane operative në 2028. 3. Marrja e tokës së kërkuar, miratimit M&S, licensave dhe lejeve. 4. Tregu i energjise është zhvilluar sipas planeve dhe synimeve me rritjen e kapaciteteve të energjise diellore. 5. Në rast se kushtet e përcaktuara në pikat ne 1, 2 dhe 4 me lart nuk janë përmbushur brenda periudhës 10-të vjeçare nga Data Efektive e Shtesës së 4-t, Koncesionari nuk do të ketë më të drejtë të zhvillojë dhe ndërtojë RP Moglica Shtese, me përjashtim të rastit kur është nënshkruar një marrëveshje me shkrim midis Palëve për shtyrjen e afatit.	Perfundimi i fazes se fizibilitetit
TM1 2025	Tenderimi i kontratës kryesore (inxhinierimi dhe tenderimi i detajuar)	Fillimi i aktivitetit
TM1 2026	Faza e Ndërtimit • Strukturat nën sipërfaqjen e tokës • Tunelet • Mekanike dhe elektrike • Linjat e transmetimit	Fillimi i aktiviteteve
TM4 2030	Data e Operimit	Fillimi i aktivitetit

Koncesionari do të informojë me shkrim Autoritetin Kontraktues pasi ka përfunduar secilën fazë, sipas rastit, në grafikun tregues më lart.

Mbi bazën e studimit të parafizibilitetit, Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues për shqyrtim dhe miratim studimin e detajuar të fizibilitetit ku të përcaktohen të gjithë elementët teknike, financiare, ekonomik dhe mjedisore, i cili do të demonstrojë se:

- RP Moglica Shtesë është i realizueshëm nga pikëpamja teknike, ekonomike, tregtare dhe financiare;

- Për RP Moglica Shtesë janë hartuar plane për zbutjen e ndikimit social dhe mjedisor;

- Ka informacione të mjaftueshme për vlerësimin e ndikimit të mundshëm të ndërtimit të RP Moglica Shtesë në shpenzimet e buxhetit të shtetit.

Studimi i plotë i fizibilitetit për RP Moglica Shtesë, pas dërgimit të tij nga Koncesionari, do të jetë objekt vlerësim nga oponenca teknike dhe bazuar në parashikimet e ligjit Nr. 125/2013 *"Për koncesionet dhe partneritetin publik privat"*, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 575/2013 *"Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritetin publik privat"*, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktues do ta përcjellë atë për miratim paraprak pranë ministrisë përgjegjëse për financat.

Miratimi i studimit të fizibilitetit për RP Moglica Shtesë, i jepet Koncesionarit nga Autoriteti Kontraktues brenda 45 ditëve pas vlerësimit dhe kryerjes së oponencës teknike dhe miratimit paraprak nga ministria përgjegjëse për financat bazuar në parashikimet e ligjit Nr. 125/2013 *"Për koncesionet dhe partneritetin publik privat"*, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 575/2013 *"Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritetin publik privat"*, i ndryshuar, mbi përballueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e projektit koncesionar, implikimet e mundshme fiskale të drejtperdrejta ose jo, mbi buxhetin e Autoritetit Kontraktues, buxhetin e shtetit ose që ndryshon me çfarëdolloj mënyre mbështetjen financiare dhe risqet fiskale që mund lindin nga miratimi i kësaj shtese të Katërt. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues do të informojë Koncesionarin me shkrim nëse ka informacion që mungon në studimin e fizibilitetit brenda 45 ditëve pas dorëzimit të studimit të fizibilitetit.

Ky miratim nuk mund të mohohet nga Autoriteti Kontraktues në mënyrë të paarsyeshme dhe ky projekt do të mund të zbatohet ligjërisht nga ana e Koncesionarit vetëm në rast miratimi të këtij studimi fizibilitetit përfundimtar nga Autoriteti Kontraktues.

G) TE DREJTAT TE TJERA PER ZHVILLIMIN E METEJSHEM

Koncesionari mund te kryeje investigime te metejshme teknike dhe mund te propozoje zgjidhje te tjera per perdorimin me te mire te potencialit te lumit Devoll. Koncesionari ka te drejte te paraqese keto propozime prane Autoriteti Kontraktues per vlerësim dhe miratim.